



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:158966

Datë: 27.10.2022

Numri i dokumentit: 03575629

PKR.nr.170/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarës S. O. nga Deçani, rr."O", nr., *për shkak të veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.212/2022 të datës 13.09.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 17.10.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarës S. O., mori dhe publikisht shpalli me dt.**18.10.2022**, ndërsa me dt.27.10.2022, nxori këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

S. O. e bija A dhe e nënës N, e gjinisë L, e lindur me dt. e lindjes në Deçan, ku edhe banon rr."O", nr., e identifikuar me numër personal ..., e pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, e pa pune, e gjendjes së dobët ekonomike, posedon telefon me numër .../...-..., Shqiptare, Shtetas e Republikës së Kosovës, **tani gjendet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt.16.07.2022, në D., në shtëpinë e saj e cila gjendet në rrugën "O." K e D., në mënyrë të pa autorizuar dhe në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022) ka mbajtur në pronësi dhe kontroll një (1) pushkë gjuetie e markës Q., prodhim turk, kal...G., me numër serik, katërmëdhjetë (14) copë fishekë kal. .. Ga, e të cilat zyrtaret policor Njësia e Hetimeve në Deçan kanë sekuestruar nga e pandehura armën dhe municionin në fjalë e të cilat i njëjta i kishte mbajtur në garazhin e shtëpisë së saj,

- me çka ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, ne bazë te nenit 4, 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39, 40, 41,42, 46,47,48, 49, 50, 69, 70, 71,72, nenit 366 par. 1, të KPRK-së, nenit 365, 366, 453, të KPRK-së, të akuzuarës i shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

- I. Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Dënimi me kusht nga dispozitivi i këtij aktgjykimi do të revokohet nëse e akuzuara kryen veprën tjetër penale.
- III. Obligohet e akuzuara që në emër të paushallin gjyqësor të paguaj shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjete) euro ne emër të kompensimin të viktimave të krimit.
- IV. **KONFISKOHEN** një (1) pushkë gjuetie e markës Q. prodhim T. , kal.. Ga, me numër serik ... dhe katërbëdhjetë (14) fishek të kal. .. Ga, dhe të njëjtat kanë për tu **SHKATËRRUAR** pasi që aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.
- V. E të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh pasi që ky aktgjykim ta merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/I. Nr.212/2022 të datës 13.09.2022, kundër të akuzuarës S. O. nga Deçani, rr.”.”, nr., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 17.10.2022 në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Lumturije Vuçetaj dhe e akuzuara S. O..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit nën shenjën PP/I. Nr.212/2022 të datës 13.09.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurores së Shtetit, të akuzuarës S. O., gjykata është bindur se e akuzuara e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarës i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarën për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe akuzuara ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë.

Prokurorja e shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të akuzuarës S. O. ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetjen në shkesat të lëndës dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarës vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarës, pasi që ajo e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, ngasë pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Raporti i oficerit O. S. i dt. 16.07.2022 shënimi zyrtar policor i rreshter F. H. i dt. 16.07.2022 deklarata e të pandehurës S. O. e dhënë në stacionin policor me dt. 16.07.2022 dhe në këtë prokurori me dt. 12.09.2022, lista e*

dëshmime nga Njësia e Forenzikës, , Lista e Armëve të konfiskuara foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Prokurorja e shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: meqenëse e pandehura e pranoi fajësinë u vërtetua gjendja faktike siç u përshkrua në aktakuzë, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpall fajtor, të dënnon sipas ligjit si dhe ta obligon në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, krahas dënimit kryesor ta shqiptoi dënim plotësues – konfiskimin e armës, gjersa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim nga ana e gjykatës si rrethanë lehtësuese të merr parsyshë pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykatë, ndërsa rrethana renduese në rastin konkret nuk kam gjetur.

E akuzuara S. O. në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: me vjen keq, ka qenë një gabim, ju premtoi se nuk do ta përsëris veprime të tilla, është hera e pare që kam ra ndesh me ligjin, nuk kam asnjë burim të ardhurave, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parsyshë rrethanat lehtësuese të potencuar nga Prokurorja e shtetit dhe të më shqiptojë dënim me të ulët me gjobë.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të akuzuarës, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuara ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që e akuzuara ka qenë e vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Kryetari i trupit gjykues me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të akuzuarën, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese mori sjelljen e saj gjatë gjykimit, ndjenjën e thellë mbi pendimin, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese bazuar në dispozitën ligjore të paraparë nenin 70 par.3 pika 3.10, 3.11 të KPRK-së, mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur, premtimin se më nuk do të bie ndesh me ligjin, pa dënushmerinë e mëparshme, përderisa rrethana rendues nuk gjeti ndaj të njëjtës. Duke pasur për bazë të gjitha këto rrethana të përmendura në raport me të akuzuarën të njëjtës i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se dispozita e nenit 49 të KPRK-së, parashihet se dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilin me ligj është i paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet dhe për kryerësin e veprës penale për të cilin është paraparë dënimi deri në dhjetë vjet burgim, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit, në rastin konkret i pandehuri ka kryer veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënim me gjobë deri 7500 euro apo dënim burgimi deri në pesë (5) vjet.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.1 dhe 70 par.3 pika 3.10, 3.11 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e saj, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KP-së.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarën e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me kusht u mor konform dispozitave ligjore të nenit 48 dhe 366 par.1 të KRPK-së.

Vendimi për mundësin e revokimit të dënimit me kusht gjykata do ta merre në përputhje me nenin 50 par.1,2,3, dhe 4, të KRPK-ës.

Vendimi për paguarjen e shpenzimeve procedurale, u morr konform nenit 450 par. 1, par.2 nën pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësuese - konfiskimin e armës dhe shkatërrimin e saj, u morr konform nenit 366 par. 3, të KRPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.170/22 dt. 27.10.2022

Bashkëpunëtorja Profesionale,
Teuta Spahija

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc.Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.